

nëpunësi i Shërbimit Publik; 2.3. nëpunësi i Kabinetit; dhe 2.4. nëpunësi administrativ dhe mbështetës.... 6. Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike. Ndërsa me nenin 82 po të këtij ligji është përcaktuar se " Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në nenet 79 deri 81 të këtij ligji, marrëdhënia e punës e nëpunësit administrativ dhe mbështetës i nënshtrohet legjislacionit të punës" rrjedhimisht, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke u bazuar në Kontratën e Punës për Kohë të Pacaktuar me numër nr.01-120-187570 të datës 28.12.2016, Kolegji i Këshillit konstatoi se pozita "Vozitës", hynë në kategorinë e nëpunësve administrativo teknik dhe mbështetës.

Lidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të të drejtave nga marrëdhënia e punës, Kolegji i Këshillit në mbështetje të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, si dhe nenit 78 dhe 79 të Ligjit 03/L-212 të Punës, thekson se nëpunësi administrativo-teknik dhe mbështetës fillimisht duhet të ankohen tek punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, andaj pas konstatimit se ankuesi nuk ka statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit vlerëson se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent që të shqyrtoj ankesat lidhur me kontestet e marrëdhënies së punës të nëpunësve administrativo-teknik dhe mbështetës, kështu që mbi këtë bazë, Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit

Marrë parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr. 1262/2022 të datës 27.12.2022, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesi nuk ka shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës, Kolegji duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1262/2022

Çlirim Zeka

Çlirim Zeka
Procesmbajtës



Eshref Shabani

Eshref Shabani
Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit për Ankesa të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;